



Përditësim

Gëzuar Vitin e Ri dhe mirë se vini në informimin e parë javor në 2025 të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje. Ky informim mbulon periudhën gjatë pushimit të Gjykatës, midis 20 dhjetorit dhe 9 janarit 2025.

Në çështjen gjyqësore *Hashim Thaçi, Bashkim Smakaj, Fadil Fazliu, Isni Kilaj dhe Hajredin Kuçi*, në lidhje me ndikim të pretenduar ndaj dëshmitarëve, z. Fazliu dhe z. Kilaj u vetëdeklaruan “të pafajshëm” gjatë paraqitjes së tyre të parë në dhjetor. Më 6 janar, z. Thaçi u vetëdeklarua “i pafajshëm” me shkrim.

Rregullorja e Procedurës dhe e Provave përcakton se i akuzuari ka 30 ditë nga paraqitja e parë të pranojë fajësinë ose të vetëdeklarohet i pafajshëm në lidhje me secilën pikë të paraqitur në aktakuzën e konfirmuar. Nëse i akuzuari nuk e bën këtë brenda kësaj periudhe, gjykatësi i procedurës paraprake automatikisht bën deklarin në emër të të akuzuarit se është “i pafajshëm”.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 20 dhjetor, Gjykatësja e Procedurës Paraprake lëshoi Vendimin Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje të Lidhura me Të. Ky vendim përcakton kalendarin për procesin e nxjerrjes së provave, gjatë të cilit Prokuroria duhet t'i japë Mbrojtjes provat që synon të përdorë gjatë gjykimit, si dhe vendos mbi aspekte të tjera lidhur me përgatitjen e shpejtë të çështjes gjyqësore për gjykim.

Në çështjen gjyqësore tjetër të *Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, lidhur me akuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, më 18 dhjetor, Trupi Gjykses miratoi kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave që një person i afërt i një viktime pjesëmarrëse në proces që ka ndërruar jetë, të marrë pjesë në proces në emër të asaj viktime. Numri i gjithsejtë i viktimave pjesëmarrëse në këtë proces gjyqësor është 154.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 20 dhjetor dhe më 6 janar, Trupi Gjykses vendosi mbi një kërkesë të Prokurorisë për të pranuar si prova dëshmitë me shkrim të dy dëshmitarëve dhe provat materiale shoqëruese, ndërsa dëshmitarët duhet të jenë në dispozicion për t'u marrë në pyetje nga pala kundërshtare. Krahas kësaj, Trupi Gjykses miratoi një kërkesë të Prokurorisë për të lejuar një dëshmitar të japë dëshmi nëpërmjet videokonferencës.

Më 24 dhjetor, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese bëri publik vendimin e saj mbi kërkesën referuese të Hashim Thaçit në të cilën ai pretendon disa shkelje të të drejtave themelore të tij për shkak të masave hetimore të posaçme të urdhëruara nga Gjykatësi i Vetëm për të akuzuarin gjatë paraburgimit të tij në 2023.





Trupi Gjykses konstatoi se sipas Kushtetutës së Kosovës dhe Rregullores së Procedurës dhe të Provave, masat hetimore të posaçme lejohen nëse janë të domosdoshme për hetimet dhe kur provat nuk mund të sigurohen në ndonjë mënyrë tjetër më pak ndërhyrëse.

Pretendimin se masat mund të kenë shkelur të drejtën e z. Taçi për gjykim të drejtë Trupi Gjykses e konstatoi të parakohshëm, si dhe të papranueshëm, duke pasur parasysh se nuk ishin përdorur të gjitha mjetet juridike.

Më 20 dhjetor 2024, doli versioni i redaktuar publik i vendimit të Trupit Gjykses i datës 22 gusht mbi kërkesën e Prokurorisë në lidhje me ndryshimin listës së provave materiale. Prokuroria kishte kërkuar që listës së provave t'i shtonte materiale hetimore të siguruara gjatë hetimeve për pengim dhe ndërhyrje ndaj një numri dëshmitarësh.

Trupi Gjykses miratoi kërkesën e Prokurorisë dhe kishte urdhëruar Prokurorinë të dorëzonte listën e ndryshuar të provave materiale jo më vonë se më 27 gusht 2024.

Trupi Gjykses konstatoi se materialet në fjalë mund të jetë relevante për t'i dhënë kontekst besueshmërisë së disa dëshmitarëve. Megjithatë, Trupi Gjykses shprehu mendimin se vlerësimi nëse materialet nga hetimi nxjerrin ndonjë provë të drejtpërdrejtë të ndikimit ndaj dëshmitarëve është jashtë kuadrit të vendimit aktual të Trupit Gjykses, sepse mandati i Trupit Gjykses nuk përfshin marrjen e vendimit nëse një person ka kryer vepra penale të tjera përveç atyre të paraqitura në aktakuzë në këtë çështje gjyqësore.

Po ashtu, Trupi Gjykses vendosi të mos lëshojë vendim lidhur me pranueshmërinë e materialeve në fjalë deri kur ZPS-ja të kërkojë të paraqesë si provë ndonjë nga ato materiale. Në rast se ndodh kjo, Trupi Gjykses do t'u japë mundësi palëve dhe pjesëmarrësve të paraqesin parashtrime nëse e gjykojnë të nevojshme.

Në çështjen gjyqësore të Sabit Januzit, Haxhi Shalës dhe Ismet Bahtijarit, më 20 dhjetor Trupi Gjykses lëshoi vendimin mbi klasifikimin e disa parashtrimeve dhe urdhëroi ekipet e Mbrojtjes të përgatitnin versionet e redaktuara publike të disa parashtrimeve.

Më 23 dhjetor u bë publik versioni i redaktuar publik i Urdhrit për Zhdëmtim kundër Pjetër Shalës.

Trupi Gjykses urdhëroi z. Shala të paguante shumën prej 208,000 euro si kompensim për dëmin fizik, mendor dhe material shkaktuar viktimave të krimeve për të cilat u shpall fajtor. Trupi Gjykses ftoi Kryetaren e DHSK-së të caktojë një Gjykatës të Vetëm përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e vënies në jetë dhe zbatimit të Urdhrit për Zhdëmtim.

Megjithëse Trupi Gjykses rikujtoi se përgjegjësinë për pagesën e kompensimit për viktimat e mban ekskluzivisht z. Shala, ai theksoi se aktualisht z. Shala nuk duket se zotëron mjetet financiare për





përmbushjen e urdhrit. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses diskutoi mundësinë e përfshirjes së aktorëve të tjerë në zbatimin e Urdhrit për Zhdëmtim. Ndër to ishin Programi aktual për Kompensimin e Viktimave të Krimeve në Kosovë si dhe mundësia që donatorë të kontribuojnë me donacione të paspecifikuara për Dhomat e Specializuara.

Trupi Gjykses gjithashtu ftoi Kosovën që të miratojë ligjet e nevojshme dhe të krijojë një mekanizëm zhdëmtues për kompensimin e viktimave të krimeve që përfshihen në juridiksionin e Dhomave të Specializuara.

Në lajme të tjera, periudha e pushimit të gjykatës përfundon këtë javë dhe seancat gjyqësore rifillojnë të hënën, 13 janar, me seancën në çështjen gjyqësore për krime lufte *Thaçi dhe të tjerët*, në orën 9 paradite.

